

R E L A C I O N
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 600, DATË 13.10.2021, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR PRONËSINË E RRUGËVE
SHTETËRORE DHE KALIMET E PRONËSISË NDËRMJET ENTEVE
PRONARE TË RRUGËVE

I. QËLLIMI I PROJEKAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektakt inicohet me qëllim miratimin e një inventari të ri rrugor shtetëror, duke patur parasysh kriteret e klasifikimit të rrugëve, sipas nenit 2 të Kodit Rrugor dhe ndërtimet e mëpasshme, që janë kryer në rrjetin rrugor shqiptar.

Projektvendimi është në zbatim të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 2 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 6 të ligjit Nr. 10164, datë 15.10.2009, “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar” dhe të nenit 4 të VKM Nr. 153, datë 7.4.2000, “Rregullore për zbatimin e Kodit Rrugor”, e ndryshuar.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME
PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE
DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektakti nuk është i planifikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME
PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektakt synon të miratojë inventarin e rrjetit rrugor shtetëror. Miratimi i këtij projektakti mbështetet në nenin 2 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 6 të ligjit Nr. 10164, datë 15.10.2009, “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar” dhe në nenin 4 të VKM Nr. 153, datë 7.4.2000, “Rregullore për zbatimin e Kodit Rrugor”, e ndryshuar.

Nëpërmjet miratimit të tij, propozohet një inventar i ri rrugor shtetëror, bazuar në inventarin e rrjetit rrugor të miratuar me VKM Nr. 600, datë 13.10.2021 “Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronarë të rrugëve”, duke patur parasysh kriteret e klasifikimit të rrugëve, sipas nenit 2 të Kodit Rrugor dhe ndërtimet e mëpasshme, që janë kryer në rrjetin rrugor shqiptar, si dhe kërkesa të veçanta nga disa bashki.

Në inventar janë shtuar unazat e ndërtuara të reja, anashkalime, akse të rinj, rrugë me destinacion pikat kufitare apo turistike, rrugët që janë në proces ndërtimi, rrugë ndërqytetëse etj.

Rrugët që nuk janë pjesë e këtij inventari, u përkasin organeve të pushtetit vendor, sipas shtrirjes territoriale. Të gjitha segmentet rrugore kombëtare janë plotësuar me kategoritë përkatëse, sipas Kodit Rrugor.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është në zbatim të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 2 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 6 të ligjit Nr. 10164, datë 15.10.2009, “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar” dhe të nenit 4 të VKM Nr. 153, datë 7.4.2000, “Rregullore për zbatimin e Kodit Rrugor”, e ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Për projekt-aktin nuk aplikohet përafrimi me Acquis të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Pika 1 e projektvendimit miraton tabelën e re të inventarit rrugor shtetëror.

- Argumentimet për kalimet e rrugëve tek ARSHH janë si vijon:

Anashkalimi perëndimor i Shkodrës, me gjatësi 5 km shtohet si rrugë e re, e sapopërfunduar, e cila shërben për të anashkaluar qytetin e Shkodrës, me qëllim lidhjen me pikën kufitare të Hanit të Hotit dhe pikat turistike të alpeve.

Rruga Baks – Rrjoll me gjatësi 8 km, - është rrugë e re e ndërtuar nga Fondi i Zhvillimit Shqiptar me destinacion drejt bregdetit turistik.

Ura e Cerencit – Sebisht (Borovë) me gjatësi 20.4 km dhe Fushe Studë – Borovë – Sebisht – 10.8 km, rrugë të reja, në përfundim të punimeve, rrugë ndërqytetëse që lidh Librazhdin me Peshkopinë.

Kthesa e Lapidarit – Rrëshen – 25.8 km. Me propozimin e Bashkisë Mat, kërkohet përfshirja në inventarin e rrjetit rrugor kombëtar si rrugë lidhëse ndërqytetëse e të gjithë aksit Ura e Matit – Urakë – Rrëshen, prej së cilës aktualisht përfshihen vetëm segmenti Ura e Matit – Kthesa e Lapidarit, me gjatësi 4.3 km. Është rrugë interurbane që lidh qytetin e Burrelit me atë të Rrëshenit.

Rruga Hekurudha - Vore 2.3 km, që aktualisht është kthyer në rrugë ku kalojnë mjetet e tonazhit të rëndë, duke shmangur Urën e Vorës.

Rrethqarkullimi i Brarit – Murriz (Rruga e Arbrit) 21.6 km- rrugë e re, pjesë e rrugës së Arbrit.

Rruga Gosë – Vila Bashtovë – gjatësi 14.6 km. Bashkia Rrogozhinë kërkon përfshirjen në inventarin e rrjetit rrugor kombëtar të segmentit Mbikalimi i fshatit Gosë – Vila Bashtovë, si rrugë që të çon në një zonë me rëndësi për turizmin historik, pasi aty ndodhet Kalaja e Vilë Bashtovës si dhe vazhdon drejt bregdetit.

Rruga Ish Reparti Ushtarak –Aeroporti i Rinasit 1 km. Rrugë e re e ndërtuar nga ARRSH me qëllim lehtësimin e trafikut në rritje për në aeroportin e Rinasit.

Rruga Belsh – Fierzë – Kosovë e Vogël -15.3 km, rrugë ndërqytetëse që lidh Belshin me Lushnjën. Me qëllim vijueshmërinë e segmentit ndërqytetës që lidh Lushnjën me Elbasanin nëpërmjet Belshit, propozojmë të përfshihet në inventarin e rrjetit rrugor kombëtar ky segment rrugor.

Rruga Drizë – Poroçan (kanioni i Holtës). Me propozimin e Bashkisë Gramsh, kërkohet ripërfshirja në inventarin e rrjetit rrugor kombëtar të segmentit Drizë – Poroçan, me gjatësi 8.7 km, duke qënë se ky segment rrugor ka si destinacion dy vende me atraksion turistik: Kanioni i Holtës dhe Shpellat e Kabashit, të cilat tërheqin një numër të lartë vizitorësh gjatë gjithë vitit.

Rruga Kuç – Qeparo - 17 km, pjesë e rrugës së Lumit të Vlorës, që të çon drejt plazhit në Qeparo.

Rruga Tepelenë – Gusmar – Kuç 34.2 km. Bashkia Tepelenë, kërkon përfshirjen në inventarin e rrjetit rrugor kombëtar të aksit rrugor Tepelenë – Gusmar – Kuç, pasi është segmenti më i shkurtër nga Tepelena me destinacion bregdetin e jugut.

Rruga Kuçovë – Frashër, 9.3 km. Me propozimin e Bashkisë Kuçovë, kërkohet përfshirja në inventarin e rrjetit rrugor kombëtar të këtij segmenti rrugor, si rrugë lidhëse ndërqytetëse ndërmjet Kuçovës dhe Gramshit. Pjesa Selitë – Mollas – Gostimë bën pjesë në inventarin e ARRSH.

Rruga Kozarë - Fier Shegan (Murriz) 7.5 km, shtuar në inventar me kërkesën e Bashkisë Kuçovë. I plotëson kriteret për të qënë rrugë kombëtare.

Rruga Korçë –Ersekë, Palasë – Dhërmi, Rruga e aeroportit te Vlorës dhe Rruga Elbasan - Librazhd janë rrugë të reja ne proces që i shtohen inventarit të rrjetit rrugor kombëtar.

- Argumentimet për kalimet nga ARSHH tek entet lokale janë si vijon:

Ura e Baçallëkut – Dobrac -5.3 km, zbritet pasi është pjesë që kalon në zonën urbane dhe është shtuar në inventar pjesa e anashkalimit perendimor të Shkodrës.

Kthesa e Lapidarit – Lis – gjatësia 8.9 km. Ky segmenti rrugor, bazuar në Kodin rrugor, nuk plotëson kriteret për të qënë pjesë e inventarit të rrjetit rrugor kombëtar.

Unaza e Burrelit – 2.5 km. Me propozimin e Bashkisë Mat, kërkohet zbritja nga inventari i rrjetit rrugor kombëtar të segmentit Unaza Perëndimore e Burrelit me gjatësi 2.5 km, pasi është një rrugë tërësisht urbane që kalon në pjesën më të banuar të qytetit.

Segmenti Fushë Studë – Stëblevë – Klenjë në Qarkun e Elbasanit dhe segmenti Klenjë – Ura e Çerenecit në Qarkun e Dibrës nuk plotësojnë kriteret për të qënë pjesë e inventarit të rrugëve kombëtare. Lidhja e Librazhdit me Peshkopinë do të bëhet nëpërmjet rrugës së re, investim i FSHZH-së.

Segmenti Kthesa e Kamzës-Bulevardi Blu – Qerek (kufiri ndarës administrativ Kamëz – Fushë Krujë), me gjatësi 7.8 km, rrugë tërësisht urbane që kalon në pjesën më të banuar të qytetit.

Segmenti Metohasim - Kafaraj (K/rrugor. Frakull-Kashishtë) - 8.5 km, nuk plotëson kriteret për të qënë rrugë kombëtare.

Segmenti rrugor Ura e Zaranikës – Rrethrotullimi i Luleve - Parku i Mallrave, Elbasan, gjatësia 4.4 km, është një rrugë e cila ka rregullim urban, me trotuare, ndriçim e gjelbërim, rrjet inxhinierik (kanalizime te ujësjellësit, energjisë, telefonise, internetit e tjerë), gjë e cila e kthen në një rrugë urbane që shtrihet brenda qytetit të Elbasanit.

Segmenti Q.Mollë - Bizë (Ballenjë) – 35.2 km, hiqet si rrugë e cila nuk plotëson kriteret për të qënë pjesë e rrjetit rrugor kombëtar.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Hartimi i Projekt-aktit të paraqitur për shqyrtim është realizuar nga MIE, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar.

Ky projektvendim është dërguar për mendim në Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Brendshme, nëpërmjet sistemit elektronik e-aktet.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i këtij vendimi nuk shoqërohet me efekte financiare në buxhetin e shtetit.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE
MINISTËR**

Belinda Balluku